

UDHËZIM
Nr. 6, datë 14.10.2019

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 2.4.2019, “PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR
SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHTETËRORE, PËR
OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)”,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 8/a, të lidhjes 1, “Metodologji për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve”, të shtohet paragrafi:

“Me vendim të Këshillit Bashkiak, për nevoja emergjente të shoqërisë, për të mos penguar funksionimin normal të aktivitetit të saj, mund të bëhet ndryshim i destinacionit të përdorimit të subvencionit, brenda zërave të kostos direkte të operimit”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të gjitha bashkitë dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**